



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Primihe/Prodato Received/Delivery	20.05.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSIK	2515/2021		116



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.386/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3080/19 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.332/2019 të datës 14.06.2019 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Nexharije Hoti me adresë Rr. "Tringë Smajli", kati 1, Banesa nr.4, në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.23/2019 të datës 27.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.332/2019 e datës 14.06.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.23/2019 i datës 27.05.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 14.06.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2718/2019 të regjistruar me numër A.nr.332/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.23/2019 të datës 27.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.06.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 15.07.2019 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional në mungesë të kuorumit, ndërsa më datë 21.08.2019, Këshilli ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës se saj , duke udhëzuar të njëjtën për të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësorë në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Ankuesja pas Njoftimit të Këshillit të datës 21.08.2019 ka hap konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.3080/19 të datës 29.304.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 25.11.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankueses së datës 14.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2718/2019 të datës 14.06.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.23/2019 me numër protokoli 420/19 të datës 27.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr.02-2069 të datës 12.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil; Listën e pagave e muajit dhjetor 2013, prill 2019 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 15.07.2019 me numër protokoli 8123/2019; Aktgjykimin A.nr.3080/19 të datës 22.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 25.11.2019 për ankuesen; Njoftimin e datës 24.02.2021; Kërkesën e datës 20.11.2019 nga ankuesja.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi konstatimit se janë pranuar kushtet ligjore për pranueshmerinë e ankesës dhe pas shqyrtimit të provave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja ka qenë e punësuar në pozitën e Udhëheqëses së Qendrës për Pajisje me Dokumente-Prishtinë”, në Agjencinë e Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me Vendimin me numër protokoli nr.02-2069 të datës 12.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil, ankueses i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit me datë 24.04.2019, duke i njohur njëkohësisht të njëjtës edhe të drejtën e realizimit të një page në vlerën e pagës se fundit mujore.

Ankuesja më datë 13.05.2019 ka parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër protokoli nr.02-2069 të datës 12.04.2019, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kërkesën për kompensim edhe tri (3) pagave mujore.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme me Vendimin Nr.23/2019 të datës 24.05.2019 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke lënë në fuqi Vendimin me Nr. 02-2069 të datës 12.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.23/2019 datës 24.05.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 14.06.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimor që vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me Ligjin e Nr.03/L-212 të Punës dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive. Kërkon që Këshilli ta detyroj Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme që ankueses t'ia njeh të drejtën e realizimit të dy pagave mujore dhe tri pagave jubilarë me rastin e pensionimit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe së e njëjta ashtu siç është përcaktuar me nenin 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ka qenë në fuqi vetëm tri vite, respektivisht deri me datë 31.12.2017, dhe e njëjta nuk është ripërtëri. Andaj, duke u nisur nga fakti se me në kohën e nxjerrës se Vendimit me numër protokoll nr.02-2069 të datës 12.04.2019 nuk ka qenë e zbatueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, Kolegji konstaton se pretendimi i ankueses për njohje të së drejtës për kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: *"Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit"*. Paragrafi 2. *Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit"*, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokoll nr.02-2069 të datës 12.04.2019, me të cilin ankueses i është njohur e drejta e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e pensionimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Bazuar në rrethanat dhe faktet e konstatuara si me lartë, Kolegji vlerëson se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.23/2019 i datës 27.05.2019, për refuzimin e ankesës së ankueses, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen e kontestuar.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesës pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, respektivisht bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.386/2021

Avdyl BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së ankueses Avokate
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

